



Komuna e Klinës  
Kryetari i Komunës  
01/2020  
Klinë, dt.10.04.2020

Duke u bazuar në nenin 13, 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, botuar në gazetën zyrtare nr. 28/2008 të publikuar me dt.04.06.2008, nenin 91 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Klinës të dt. 07.04.2010, vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/07 të datës 11.03.2020 dhe plotësim ndryshimit të tij, lidhur me gjendjen e krijuar me qëllim të parandalimit nga infeksioni i Corona Virus COVID-19, si dhe vendimin nr.01/11 të datës 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, më akordimin edhe të grupit për gatishmëri emergjente të datës 10.04.2020, Kryetari i Komunës së Klinës, më dt. 10.04.2020, merr;

## V E N D I M

1. **LIROHEN**, qytetaret e Komunës së Klinës nga participimet lidhur më ofrimin e shërbimeve dhe vizitave mjekësore në QKMF "Nënë Tereza" në Klinë, gjate periudhës së fazës emergjente në shëndetin publik të krijuar si pasojë e paraqitjes së infeksionit COVID-19.
2. Zbatimi i këtij vendimi behet nga ana e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, si dhe QKMF "Nënë Tereza" në Klinë.
3. Vendimi i është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë, i cili do të zbatohet deri në tejkalimin e situatës emergjente në shëndetësi.

### Te njoftohet:

- DSHMS;
- QKMF "Nënë Tereza" Klinë
- Shtabi emergjent;
- Tabelën e shpalljeve;
- Arkivi.



Kryetari,  
Zenun Elezaj